

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A  
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ /09/2026

**LËNDA: PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE**

I mbajtur sot në datë 08.09.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, Znj. Stela Koçi dhe Znj. Renata Done persona përgjegjës, të emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit Nr. 838/3 Prot, datë 08.09.2026 për procedurën e prokurimit me objekt: “Pajisje primare, sekondare dhe pajisje ndihmëse për N.Stacione dhe Linjat TL”.

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):** Transformatorë 31170000-8. Transformatorë tensioni 31172000-2, Kabllo të tensionit të lartë 31321300-5, Panele centralesh 32542000-4.

**Vlera e fondit limit: 219,713,300.61** (Dyqind e nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e treqind lekë e gjashtëdhjetë e një qindarka) lekë pa TVSH ose 2,379,235.60) euro pa TVSH. Kursi kembimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 08.09.2026 është 92.35 (nëntëdhjetë e dy pikë tridhjetë e pesë).

Për argumentimin e fondit limit grupi i punës i caktuar me urdher të titullarit të Ak-se, j'u referuan studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
  - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
  - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
  - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.
- Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

### ARGUMENTIMI NË LIDHJE ME NENIN 39 TË LIGJIT NR. 162, DATË 23.12.2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, I NDRYSHUAR, PËR MOSNDARJEN NË LOTE TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Procedura e prokurimit me objekt “**Pajisje primare, sekondare dhe pajisje ndihmëse për N.Stacione dhe Linjat TL**” ka për qëllim furnizimin e Autoritetit Kontraktor me pajisje dhe materiale të ndryshme elektrike, të cilat përdoren për mirëmbajtjen, funksionimin dhe garantimin e vazhdimësisë së punës së N/Stacioneve dhe linjave të Tensionit të Lartë, në funksion të veprimtarisë së punës së Autoritetit Kontraktor.

Objekti i prokurimit përfshin pajisje primare, sekondare dhe ndihmëse, ndër të cilat rele digjitale për mbrojtje dhe komandim fideri, radrizatorë dhe rele kohe, transformatorë rryme 110 kV dhe 35 kV, shkarkues TM dhe TL, izolatorë TL dhe TM, terminale dhe muftë TM, kablo TM, si dhe pajisje të tjera elektrike dhe ndihmëse të nevojshme për N/Stacionet dhe Linjat. TL.

Gjithashtu, në objekt përfshihen pajisje primare për eliminimin e ferorezonancës, klema rryma, bateri të thata me gel, rack metalik për bateritë, çelësa, rezistenca të tokëzimit të neutrit, sensorë alarmi, kanalina, kapakë metalikë, dron profesional për monitorimin e linjave TL, ventilatorë ftohës për transformatorë fuqie dhe box-e metalike për ambient të jashtëm.

Në vijim, objekti përfshin edhe një kontenier metalik për pajisje TM, të kompletuar me pajisjet dhe instalimet elektrike përkatëse, përfshirë kasetë elektrike, automatikë, përcjellës, priza, kuti derivacioni, tuba elektrikë, çelësa, ndriçues dhe kondicionerë.

Referuar procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktor ka analizuar mundësinë e ndarjes së objektit në lote dhe, pas vlerësimit të natyrës së furnizimeve, destinacionit të tyre dhe mënyrës së përdorimit në N/Stacionet dhe Linjat TL, vlerëson se **procedura nuk është e përshtatshme për t’u ndarë në lote**, pasi një ndarje e tillë do të mund të krijonte vështirësi në koordinimin e furnizimeve, në menaxhimin e kontratës dhe në përcaktimin e përgjegjësisë kontraktuale.

Pajisjet, megjithëse janë të kategorive të ndryshme teknike, janë pjesë e një pakete të unifikuar furnizimesh të destinuara për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së N/Stacioneve dhe Linjave TL. Për një pjesë të tyre ekziston edhe një marrëdhënie e drejtpërdrejtë funksionale dhe teknike me pajisje të tjera të instalimit ku ato përdoren.

Për këtë arsye, krijimi i marrëdhënieve kontraktore me disa Operatorë Ekonomikë mund të sjellë vështirësi në koordinimin e furnizimeve dhe në rastin kur një pajisje apo material i nevojshëm për një ndërhyrje të caktuar furnizohet nga një Operator Ekonomik, ndërsa pajisjet ose materialet e tjera të nevojshme furnizohen nga një Operator Ekonomik tjetër.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në një situatë të tillë, Autoriteti Kontraktor nuk mund të disponojë në mënyrë të plotë një element të nevojshëm për ndërhyrjen dhe të presë furnizimin e elementeve të tjera, nëse këto do të ishin objekt i loteve dhe kontratave të ndryshme.

Kjo situatë mund të krijojë **vonesa në furnizim, vështirësi në planifikimin e ndërhyrjeve, mospërputhje në afatet e furnizimit dhe, në raste të caktuara, pamundësi të përkohshme për realizimin e ndërhyrjes së planifikuar**, duke ndikuar në ushtrimin normal të funksioneve të Autoritetit Kontraktor.

Në veçanti, duke pasur parasysh natyrën e infrastrukturës së Tensionit të Lartë, disponueshmëria në kohë e pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për mirëmbajtje, zëvendësim ose ndërhyrje teknike është një element i rëndësishëm për garantimin e vazhdimësisë dhe sigurisë së funksionimit të sistemit.

Gjithashtu, ndarja e objektit në lote do të rriste kompleksitetin e administrimit të kontratës, pasi do të kërkohej menaxhimi paralel i disa marrëdhënieve kontraktore, me operatorë ekonomikë të ndryshëm, afate të ndryshme furnizimi, dokumentacion teknik, kushte garancie dhe përgjegjësi të ndara.

Në këtë kuadër, **ndarja në lote do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë**, duke e bërë më kompleks koordinimin ndërmjet furnitorëve dhe realizimin me sukses të nevojave të Autoritetit Kontraktor.

### Baza ligjore

Referuar **Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar**, neni 2 përcakton qëllimet e ligjit, ndër të tjera:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në vlerësimin e mosndarjes së objektit në lote, Autoriteti Kontraktor ka mbajtur në konsideratë këto qëllime të ligjit, duke vlerësuar njëkohësisht nevojën për efikasitet, efektivitet, mirëpërdorim të fondeve publike dhe administrim sa më efikas të kontratës.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në këtë drejtim, **Kreu V, neni 42, pikat 1 dhe 2 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar**, parashikon:

“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.”

Ndërkohë, pika 2 parashikon detyrimin e Autoritetit Kontraktor, në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, që në rastin e zhvillimit të procedurës pa ndarje në lote, të përcaktojë qartë arsyet kryesore për këtë vendim, të cilat bëhen pjesë e dosjes së tenderit.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktor ka kryer këtë vlerësim dhe arsyet e mosndarjes në lote lidhen me **natyrën e furnizimeve, nevojën për koordinim të tyre, menaxhimin e afateve, shmangien e fragmentimit të furnizimit dhe administrimin e përgjegjësiave kontraktuale.**

### **Mundësia e pjesëmarrjes së bashkimeve të operatorëve ekonomikë**

Në vlerësimin e ndikimit të mosndarjes në lote mbi konkurrencën, Autoriteti Kontraktor ka marrë në konsideratë edhe mundësinë e pjesëmarrjes së bashkimeve të operatorëve ekonomikë.

Referuar **Nenit 14 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar**, operatorët ekonomikë mund të paraqiten individualisht ose në grupe operatorësh ekonomikë, sipas parashikimeve të rregullave të prokurimit publik.

Në mënyrë të posaçme, legjislacioni parashikon mundësinë që **grupet e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm**, ndërsa autoriteti kontraktor nuk duhet t’u kërkojë atyre një formë të veçantë ligjore për qëllimin e dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Gjithashtu, **neni 88 i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar**, parashikon mundësinë e paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë, si dhe përcaktimin në kontratën e bashkëpunimit të pjesës së furnizimit që do të kryejë secili anëtar i bashkimit.

Në këtë kuptim, fakti që procedura zhvillohet si një objekt i vetëm **nuk përjashton mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë që nuk disponojnë individualisht të gjitha kapacitetet e nevojshme**, pasi ata mund të organizohen në formën e lejuar nga legjislacioni i prokurimit publik, duke kombinuar kapacitetet dhe eksperiencat e tyre për realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se mosndarja në lote, e arsyetuar nga nevojat konkrete të realizimit të objektit, **nuk synon dhe nuk ka për qëllim kufizimin e konkurrencës**, por lidhet me nevojën për një realizim sa më efikas, të koordinuar dhe të administrueshëm të furnizimeve.

### **Përfundimi**

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se **ndarja e procedurës së prokurimit me objekt “Pajisje primare, sekondare dhe pajisje ndihmëse për N.Stacione dhe Linjat TL” në lote nuk është e përshtatshme në raport me mënyrën e planifikimit, furnizimit dhe përdorimit të pajisjeve dhe materialeve objekt prokurimi.**

Ndarja në lote do të mund të krijonte fragmentim të furnizimeve, vështirësi në koordinimin e afateve, varësi nga furnizime të kryera nga operatorë të ndryshëm, si dhe komplikime në administrimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësi.

Në të kundërt, zhvillimi i procedurës si një objekt i vetëm mundëson:

- koordinim më të mirë të furnizimit;
- menaxhim më efikas të kontratës;
- administrim më të thjeshtë të afateve dhe garancive;
- qartësi më të madhe në përcaktimin e përgjegjësi kontraktuale;
- shmangien e vonesave që mund të shkaktohen nga varësia ndërmjet furnizimeve të loteve të ndryshme;
- garantimin e disponueshmërisë në kohë të pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin e N/Stacioneve dhe Linjave TL.

Për sa më sipër, **Autoriteti Kontraktor, në zbatim të Nenit 39 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 42 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, vlerëson dhe argumenton se procedura e prokurimit duhet të zhvillohet si një objekt i vetëm, pa ndarje në lote, pasi kjo mënyrë realizimi është më e përshtatshme për garantimin e eficiencës, efektivitetit, koordinimit të furnizimeve dhe përmbushjes në kohë të nevojave të Autoritetit Kontraktor.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- 
- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: *"Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata"*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës."* dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: *"3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i*

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

*suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiros minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.*

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit të lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- 1.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të balanceve të viteve (2023, 2024, 2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe*

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

*kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.*

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitet ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitet ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve të tre viteve të fundit finaciare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe finaciare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

- 1.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë shlyer detyrimet finaciare të taksave vendore të parashikuara nga Njësia/të e Pushtetit Vendor për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026, referuar ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në të cilën/at janë regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi. Dokumentet provuese / vërtetimet të / e kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

### Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt kontrate, në të cilën duhet të deklarojnë emërtesën e artikullit dhe të dhënat e kërkuara, sipas tabelës së mëposhtme dhe që plotësojnë kërkesat sipas skedës teknike të ofruar nga ata:

**Tabelat e të dhënave teknike të pajisjeve të kërkuara dhe ato të ofruar nga operatorët ekonomik.**

| Nr. | Emertimi i pajisjes                                         | Kompania Prodhuese e artikullit të ofruar | Referenca për specifikimet teknike sipas katalogëve të artikullit të ofruar |
|-----|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| 1.  | • Rele digjitale për mbrojtje/komandim fideri 48-250 VDC/AC |                                           |                                                                             |
| 2.  | • Rele kohe                                                 |                                           |                                                                             |
| 3.  | • Radrizator 400 V AC / 90-300 V DC                         |                                           |                                                                             |
| 4.  | • Transformatore rryme ambjent i jashtëm 110kV              |                                           |                                                                             |
| 5.  | • Transformatore rryme ambjent i jashtëm 35kV               |                                           |                                                                             |
| 6.  | • Shkarkues TL 110kV                                        |                                           |                                                                             |
| 7.  | • Shkarkues TM 35kV                                         |                                           |                                                                             |
| 8.  | • Izolatore TM                                              |                                           |                                                                             |

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

|     |                                                                                            |  |  |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
| 9.  | • Kabell 24kV, percjelles Cu, XLPE<br>1x630/35Cu mm <sup>2</sup>                           |  |  |
| 10. | • Kabell 24kV, percjelles Cu, XLPE<br>1x240/25Cu mm <sup>2</sup>                           |  |  |
| 11. | • Terminale TM                                                                             |  |  |
| 12. | • Mufte TM                                                                                 |  |  |
| 13. | • Pajisje primare për eliminimin e<br>ferrorezonancës në Transformatore tensioni           |  |  |
| 14. | • Kontenier metalik                                                                        |  |  |
| 15. | • Bateri te thata, me gel 12V DC                                                           |  |  |
| 16. | • Rack metalik per ambjent i brendshem per<br>bateri te thata, me ventilim, per N.Stacione |  |  |
| 17. | • Çelsa discrepancy sëitch                                                                 |  |  |
| 18. | • Rezistenca e tokezimit te neutrit, ana 20kV,<br>per dy transformatore fuqie              |  |  |
| 19. | • Sensor alarmi per cela 20kV                                                              |  |  |
| 20. | • Izolatore bushing 20kV per transformatore<br>fuqie                                       |  |  |
| 21. | • Terminal kabllor (bushing) 20kV, per<br>transformatore fuqie                             |  |  |
| 22. | • Drone profesional per monitorimin e linjave<br>TL                                        |  |  |
| 23. | • Ventilatore ftohes                                                                       |  |  |
| 24. | • Box metalik per ambjent te jashtem<br>N.Stacioni te kompletuar                           |  |  |

**2.3.3.** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi i deklaruar i pajisjeve që ofrojnë (sipas deklarimit në skedën teknike) ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi për realizimin e furnizimeve me artikujt objekt kontrate. Nëse do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar nga prodhuesit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Autorizimi në çdo rast duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

## OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e autorizimi të prodhuesit, distributori i autorizuar prej tij se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një kërkesë e rëndësishme, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofertimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë natyrën teknike dhe rendesine e pajisjeve që do të furnizohen dhe përdoren në N.Stacione elketrike, është e rëndësishme që produktet e ofruara të sigurohen nëpërmjet një operatori të identifikueshëm dhe të autorizuar të furnizimit. Kjo i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë që Operatori Ekonomik ka marrëdhënie të ligjshme dhe të vlefshme me prodhuesin ose me një distributor të autorizuar prej tij për furnizimin me artikujt objekt kontrate.

Kërkesa synon gjithashtu të minimizojë riskun e furnizimit me produkte të falsifikuara, të modifikuara, me origjinë të pasigurt ose që nuk përputhen me produktet dhe specifikimet teknike të deklaruara në ofertë, si dhe të sigurojë gjurmueshmërinë e zinxhirit të furnizimit.

Në rastin kur autorizimi paraqitet nga një distributor, kërkesa për të provuar lidhjen ndërmjet Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit është e nevojshme për të verifikuar vlefshmërinë e këtij autorizimi dhe për të garantuar që distributori ka të drejtë të autorizojë Operatorin Ekonomik për furnizimin me produktet përkatëse.

